

VENDIM
Nr. 986, datë 9.12.2015

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES, MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRISË, PËR
SHËRBIMIN GJEOLGJIK SHQIPTAR, TË NJË OBJEKTI DHE TË TRUALLIT
FUNKSIONAL BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 6, ME EMËRTIM
“INSTITUTI GJEOGRAFIK I USHTRISË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN
“MYSLYM KETA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, për një periudhë 35-vjeçare, të objektit nr. 5 dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 747 (shtatëqind e dyzet e shtatë) m², brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, me vendndodhje në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë, për t’u përdorur në funksion të veprimtarisë së administratës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e objektit dhe të truallit funksional, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënie në përdorim të përkohshëm të objektit dhe të truallit funksional, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Energjisë dhe Industrisë, drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN VENDOSJA E REP. USHT. 7030, IGJIU
Prona nr.6

SISTEMI I KOORDINATAVE SHETERORE

581
070

581
030

580
930

580
830

SPJEGUESE

SIPERFAQJA E PERGJITHESHME 17692.94 m²
SIPERFAQJA ME OBJEKTE 4009.91 m²

— kufiri i repartit

— Pjesa e pronës që sipas VKM nr.543, datë 18.06.2015 i ka kaluar në përdorim të përkohshëm MEI për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, me sipërfaqe 5000 m²

Objekti Nr.6, 3 kt me sipërfaqe nën objekt = 609 m² i cili ndodhet në këtë sipërfaqe

— Pjesa e pronës që kërkohet t'i shtohet VKM nr.543, datë 18.06.2015 për përdorim të përkohshëm MEI për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, me sipërfaqe 747 m²

Objekti Nr.5, 1 kb me sipërfaqe nën objekt = 200 m² i cili ndodhet në këtë sipërfaqe

SHENIM:

Për ndarjen e pronës për kalim kapital u punua mbi plan vendosjen e marrë në Arkivin e IGJIU të hartuar në vite

4 Punuar në Shtator 2015

4 403 650

403 750

403 850

403 900